

1. Për ankesat ndaj kontrolluesve publikë 2019 dhe 2020

- 1.1 Sa ankesa të depozituara në zyrën e Komisionerit (nga totali vjetor i 2019 dhe 2020) kanë qenë për shkelje nga kontrollues/institucione publike?
- 1.2 Në sa prej këtyre rasteve Komisioneri ka gjetur shkelje të Ligjit për “Mbrojtjen e të dhënave personale”? (Numrat dhe datat e vendimeve përkatëse të aksesueshëm online ku janë gjetur shkelje.)

2. Për hetimet administrative me iniciativë ndaj kontrolluesve publikë 2019 dhe 2020

- 2.1 Sa hetime administrative me nismën e Komisionerit (nga totali vjetor i 2019 dhe 2020) në lidhje me institucione/kontrollues publikë ka patur në raport me totalin e hetimeve me iniciativë të ndërmarra gjatë kësaj periudhe?
- 2.2 Në sa prej këtyre rasteve Komisioneri ka gjetur shkelje të Ligjit për “Mbrojtjen e të dhënave personale”? (Numrat dhe datat e vendimeve përkatëse të aksesueshëm online ku janë gjetur shkelje.)

3. Gazetarët/shoqëria civile

- 3.1 A ka patur ankesa të depozituara apo hetime (përgjatë gjithë veprimtarisë së institucionit të Komisionerit) nga gazetarë apo persona të angazhuar në shoqërinë civile për shkelje të Ligjit për “Mbrojtjen e të dhënave personale” ku pretendohet ndër të tjera që shkelja kishte lidhje me punën/angazhimin e tyre publik?
- 3.2 Nëse po, sa ankesa/hetime të tilla ka patur?
- 3.3 Në sa prej këtyre rasteve Komisioneri ka gjetur shkelje të ligjit? (Numrat dhe datat e vendimeve përkatëse të aksesueshëm online ku janë gjetur shkelje.)

4. Partitë politike

- 4.1 A ka patur ankesa të depozituara apo hetime (përgjatë gjithë veprimtarisë së institucionit të Komisionerit) ndaj partive politike për shkelje të Ligjit për “Mbrojtjen e të dhënave personale” ?
- 4.2 Nëse po, sa ankesa/hetime të tilla ka patur ndër vite?
- 4.3 Në sa prej këtyre rasteve Komisioneri ka gjetur shkelje të ligjit? (Numrat dhe datat e vendimeve përkatëse të aksesueshëm online ku janë gjetur shkelje.)

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Zyra e Komisionerit”) ka administruar kërkesën tuaj për informacion me nr. 1531 prot., datë 16.09.2021, të dërguar nëpërmjet postës elektronike. Më poshtë, ju vendosim në dispozicion informacionin e kërkuar.

Në lidhje me pyetjen e parë të kërkesës, për vitin 2019 u administruan gjithsej 301 ankesa me objekt mbrojtjen e të dhënave personale nga qytetarë. Prej këtij numri, 76 ankesa ishin ndaj kontrolluesve publik. Nga shqyrtimi i tyre administrativ, në vetëm një rast Komisioneri është shprehur me Urdhrin nr. 261, datë 25.09.2019, të cilin e konsultoni në lidhjen

<https://www.idp.al/urdhra-2019/>. Ndërsa, ankesat e tjera (75) janë zgjidhur gjatë procesit të hetimit administrativ ose kanë rezultuar jashtë objektit të ligjit.

Për vitin 2020, Zyra e Komisionerit ka administruar gjithsej 308 ankesa me objekt mbrojtjen e të dhënave personale nga qytetarët. Nga ky numër, 98 ishin ndaj kontrolluesve publik, të cilat janë zgjidhur gjatë procesit të hetimit administrativ ose kanë rezultuar jashtë objektit të ligjit.

Në lidhje me *pyetjen e dytë* të kërkesës, ju informojmë se për vitin 2019 janë kryer gjithsej 142 inspektive, të cilat kategorizohen si më poshtë

- 67 hetime administrative në kontrollues publik dhe 75 në kontrollues privat;
- 108 inspektive me iniciativë të Zyrës së Komisionerit dhe 34 mbi bazë ankese.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ në lidhje me këto inspektive, Komisioneri ka dalë me:

- 27 *Rekomandime*, të listuara si më poshtë dhe që i konsultoni në lidhjen <https://www.idp.al/rekomandime-2019/>:

Rekomandim Nr. 1 - Instituti i të Miturve Kavajë;

Rekomandim Nr. 2 - Agjencia Kombëtare e Mjedisit;

Rekomandim Nr. 3 - Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare;

Rekomandim Nr. 4 - Autoriteti i Mediave Audiovizive;

Rekomandim Nr. 5 - Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural;

Rekomandim Nr. 6 - Inspektorati Qendror;

Rekomandim Nr. 7 - Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit;

Rekomandim Nr. 8 - Komiteti për Pakicat Kombëtare;

Rekomandim Nr. 9 - Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor;

Rekomandim Nr. 10 - Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile;

Rekomandim Nr. 11 - Agjencia Telegrafike Shqiptare;

Rekomandim Nr. 12 - Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike;

Rekomandim Nr. 13 - Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave;

Rekomandim Nr. 14 - Agjencia e Prokurimit Publik;

Rekomandim Nr. 15 - Autoriteti për Informimin mbi Dokumentat e Ish-Sigurimit të Shtetit;

Rekomandim Nr. 16 - Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore;

Rekomandim Nr. 17 - Komiteti Shtetëror për Kultet;

Rekomandim Nr. 18 - Akademia e Shkencave;

Rekomandim Nr. 19 - Shërbimi Kombëtar i Punësimit;

Rekomandim Nr. 20 - Komisioni i Prokurimit Publik;

Rekomandim Nr. 21 - Autoriteti Shëndetësor Rajonal Tiranë;

Rekomandim Nr. 22 - Qendra e Botimeve Zyrtare;

Rekomandim Nr. 23 - Instituti i Mjekësisë Ligjore;

Rekomandim Nr. 24 - Shkolla Shqiptare e Administratës Publike;

Rekomandim Nr. 26 - Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile;

Rekomandim Nr. 49 - Operatori i Sistemit të Transmetimit;

Rekomandim Nr. 69 - Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve.

- 3 Vendime me masë administrative (gjobë) të listuara më poshtë, të cilat i konsultoni në lidhjen <https://www.idp.al/vendime-2019-ha/>:

Vendim Nr. 10 - Spitali Rajonal Fier;

Vendim Nr. 12 - Spitali Rajonal Shkodër;

Vendim Nr. 13 - Spitali Rajonal Durrës.

Për vitin 2020 janë kryer 60 inspektive, të cilat kategorizohen si më poshtë:

- 15 hetime administrative në kontrollues publik dhe 45 në kontrollues privat;
- 39 inspektive me iniciativë të Zyrës së Komisionerit dhe 21 mbi bazë ankese.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ në lidhje me këto inspektive, Komisioneri ka dalë me 2 Rekomandime unifikuese për institucionet e administratës shtetërore, që mund t'i konsultoni në lidhjen <https://www.idp.al/rekomandime-2020/>:

Rekomandim Nr. 1 - Për caktimin e personit të kontaktit (Mbi respektimin e detyrimeve ligjore në kuadër të mbrojtjes së të dhënave personale nga organet e administratës shtetërore);

Rekomandim Nr. 2 - Për publikimin e “Politikave të Privatësisë” në faqet zyrtare nga institucionet e administratës shtetërore (Mbi respektimin e detyrimeve ligjore në kuadër të mbrojtjes së të dhënave personale nga organet e administratës shtetërore).

Në lidhje me *pyetjen e tretë*, Zyra e Komisionerit ju informon se nuk kryen një përpunim statistikor të kësaj natyre.

Në lidhje me *pyetjen e katërt*, ju informojmë, se prej krijimit të Zyrës së Komisionerit deri në vitin 2020, nuk ka patur ankese të qytetarëve ndaj subjekteve politike. Në vitin 2014, Komisioneri është shprehur me 2 Rekomandime për përmbushjen e detyrimeve ligjore nga subjektet politike, akte të cilat i konsultoni në lidhjen <https://www.idp.al/rekomandime-2014/>:

Rekomandim Nr. 12 - Partia Socialiste e Shqipërisë;

Rekomandim Nr. 13 - Partia Demokratike e Shqipërisë.

Ndërsa, për vitin 2021 janë administruar deri tani 41 ankese ndaj subjekteve të ndryshme politike. Në lidhje me to, Zyra e Komisionerit ka realizuar 2 inspektive administrative pranë këtyre kontrolluesve, ku Komisioneri ka dalë me Rekomandim Nr. 44, datë 19.08.2021 (<https://www.idp.al/rekomandime-2021/>) dhe me Urdhër Nr. 91, datë 22.06.2021 (<https://www.idp.al/urdhra-2021/>).